



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 11 qershor 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit

Zyrës së Prokurorit të Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Luka Mishetiç

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II i Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Trupi Gjykues”), në bazë të neneve 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullave 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Historiku procedural në lidhje me rishikimin e rregullt të paraburgimit të Hashim Thaçit (“z. Thaçi”) është shtjelluar gjerësisht në vendimet e mëparshme. Ngjarjet relevante që nga rishikimi i rregullt i fundit i paraburgimit (“Vendimi i Njëzetë për Paraburgimin”)¹ përfshijnë si në vijim.
2. Më 15 prill 2025, ZPS-ja dorëzoi njoftimin për mbylljen e paraqitjes së provave të saj.²
3. Më 20 maj 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi parashtrimet e saj në lidhje me rishikimin e paraburgimit të z. Thaçi (“Parashtrimet e ZPS-së”).³
4. Mbrojtja e z. Thaçi dorëzoi përgjigje ndaj parashtrimeve të ZPS-së (“Përgjigja”).⁴
5. ZPS-ja nuk u kundërpërgjigj.

¹ F03106, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 11 prill 2025.

² F03121, Prokurori i Specializuar, *Njoftimi i Prokurorisë sipas Rregullës 129*, 15 prill 2025.

³ F03184, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 20 maj 2025.

⁴ F03220, Mbrojtja, *Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Parashtrimit të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 20 maj 2025.

II. PARASHTRIMET

6. ZPS-ja parashtron se mbajtja në paraburgim e z. Thaçi vijon të jetë e përligjur.⁵ Sipas ZPS-së, që nga vendimi i fundit mbi rishikimin e paraburgimit të z. Thaçi, nuk ka pasur asnjë ndryshim material të rrethanave që do të përligjte një përfundim të ndryshëm.⁶ ZPS-ja parashtron se mbyllja e paraqitjes së provave të saj dhe nxjerrja e mëtejshme e informacionit të ndjeshëm në lidhje me dëshmitarë dhe viktima pjesëmarrëse shton rrezikun e arratisjes, pengimit dhe kryerjes së krimeve të tjera.⁷ ZPS-ja parashtron se asnjë kusht tjetër përveç paraburgimit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”) (“objekti i paraburgimit i DHS-së”) nuk do të mjaftonte për të zvogëluar rreziqet e përfshira në nenin 41, dhe se paraburgimi vazhdon të jetë proporcional.⁸

7. Mbrojtja e Thaçit përgjigjet se mbyllja e paraqitjes së provave nga ZPS-ja nuk përbën ndryshim kyç të rrethanave që shton rreziqet nga neni 41(6).⁹ Mbrojtja parashtron se, sikurse është konfirmuar nga Trupi Gjykses në vendimet e tij të fundit për paraburgimin, z. Thaçi nuk përbën rrezik arratisjeje dhe nuk paraqet rrezik për pengimin e procesit, në veçanti pasi mbyllja e paraqitjes së provave të ZPS-së kundër të akuzuarit duhet të zvogëlojë rrezikun e ndërhyrjes.¹⁰

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Dispozitat ligjore të zbatueshme për vendimin në lidhje me paraburgimin përcaktohen në nenin 41 dhe rregullat 56 dhe 57, dhe janë shtjelluar gjerësisht në

⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 8-31.

⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 8.

⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 8.

⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 28-30.

⁹ Përgjigjja, para. 12, 14, 16, 18.

¹⁰ Përgjigjja, para. 9-21.

vendime të mëparshme.¹¹ Trupi Gjykses do t'i zbatojë këto standarde në këtë vendim.

IV. DISKUTIM

9. Qëllimi i rishikimit të paraburgimit çdo dy muaj sipas nenit 41(10) është që Trupi Gjykses të përcaktojë nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtjen në paraburgim.¹² Ndryshimi i rrethanave, ndonëse nuk është përcaktues, do të merret parasysh nëse ngrihet para trupit gjykses përkatës, ose *proprio motu*.¹³

10. Duke mbajtur parasysh fazën e tanishme të procesit, konkretisht periudhën pas mbylljes së paraqitjes së provave të ZPS-së, Trupi Gjykses do të shqyrtojë faktorët nga neni 41(6) për tu bindur se rrethanat mbi të cilat mbështetet paraburgimi i z. Thaçi vijojnë të ekzistojnë, duke përligjur vazhdimin e paraburgimit të tij.

A. KRITERET E NENIT 41

1. Dyshimi i bazuar

11. Sa i përket standardit për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) kërkon ekzistencën e dyshimit të bazuar se personi i paraburgosur ka kryer vepër penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së. Ky është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimin të paraburgimit të personit të paraburgosur.¹⁴

¹¹ *Shih, p.sh.*, F00994, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 29 shtator 2022, konfidencial, para. 18-21. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 6 tetor 2022, F00994/RED.

¹² IA022/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit*, 22 gusht 2022, konfidencial, para. 37. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA022/F00005/RED.

¹³ IA010/F00008, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit*, 27 tetor 2021, konfidencial, para. 19. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA010/F00008/RED.

¹⁴ *Shih* ECtHR, *Merabishvili v. Georgia* [GC], no. 72508/13, [Judgment](#), 28 November 2017, para. 222.

12. ZPS-ja parashtron se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Thaçi ka kryer krim që përfshihet në juridiksionin e DHS-së.¹⁵

13. Trupi Gjykes thekson se, në bazë të nenit 39(2), Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Thaçi është penalisht përgjegjës për një numër krimesh kundër njerëzimit (përndjekje, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë) dhe krimesh lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme) sipas neneve 13, 14(1)(c) dhe 16(1)(a).¹⁶ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ekzistenca e dyshimit të bazuar mirë është vërtetuar edhe në lidhje me akuzat e reja të ngritura nga ZPS-ja kundër z. Thaçi.¹⁷ Këto konstatime u bënë mbi bazën e një standardi më të lartë se ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a).¹⁸

¹⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9.

¹⁶ F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 521(a). Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 19 nëntor 2020, F00026/CONF/RED. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 nëntor 2020, F00026/RED. Versioni konfidencial me më pak redaktime u dorëzua më 5 qershor 2025, F00026/CONF/RED3. Prokurori i Specializuar dorëzoi aktakuzën e konfirmuar me parashtrimin F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të*, 30 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale; F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë e Redaktuar më Tej*, 4 nëntor 2020; F00134, Prokurori i Specializuar, *Version me më pak Redaktime i Aktakuzës së Redaktuar*, KSC-BC-2020-06/F00045/A02, 4 nëntor 2020, 11 dhjetor 2020, konfidencial. Versioni i korrigjuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 3 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (F00455/RED/A01) me versionin e redaktuar konfidencial (F00455/CONF/RED/A01) dhe versionin e redaktuar publik (F00455/RED/A01). Më 17 janar 2022, Prokurori i Specializuar dorëzoi versionin konfidencial të korrigjuar dhe me më pak redaktime të Aktakuzës së Konfirmuar, F00647/A01.

¹⁷ F00777, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzë*, 22 prill 2022, konfidencial, para. 183. Versioni i redaktuar publik (F00777/RED) u dorëzua më 6 maj 2022. Ndryshimet e kërkuara paraqiten me hollësi në para. 11. ZPS-ja më pas dorëzoi aktakuzën e ndryshuar të konfirmuar më 29 prill 2022 (“Aktakuza e Konfirmuar”), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00789/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00789/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00789/A05). Aktakuza e Konfirmuar konfidenciale e ndryshuar më tej u dorëzua më 30 shtator 2022, (F00999/A01), me versionin e redaktuar publik (F00999/A03). Versioni publik me më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 15 shkurt 2023 (F01296/A03) dhe më 27 shkurt 2023 (F01323/A01).

¹⁸ *Shih, p.sh.*, IA008/F00004, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 21. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA008/F00004/RED.

14. Në mungesë të ndonjë rrethane materiale të re që do të ndikonte në konstatimet e mësipërme, Trupi Gjykses gjykon se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Thaçi ka kryer krime që përfshihen në juridiksionin lëndor të DHS-së, sipas nenit 41(6)(a) dhe (10).

2. Domosdoshmëria e paraburgimit

15. Në lidhje me arsyet për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(b) përcakton tri arsye (rreziqe) alternative në bazë të të cilave mund të konstatohet se paraburgimi është i domosdoshëm: (i) rreziku i arratisjes; (ii) rreziku i pengimit të procesit; ose (iii) rreziku i kryerjes së krimeve të tjera.¹⁹ Paraburgimi vazhdohet nëse ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se një ose më shumë nga këto rreziqe do të materializohen.²⁰ “Të artikulueshme” në këtë kontekst përdoret në kuptimin që arsyet duhet të specifikohen me hollësi, duke iu referuar informacionit ose provave përkatëse.²¹ Në përcaktimin nëse ekziston ndonjë prej arsyeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) për paraburgimin e një personi, standardi i zbatueshëm është më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që ndonjë prej rreziqeve të materializohet.²²

¹⁹ *Shih* ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], no. 23755/07, [Judgment](#) (“*Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC]”), 5 July 2016, para. 88; ECtHR, *Zohlandt v. the Netherlands*, no. 69491/16, [Judgment](#), 9 February 2021, para. 50; ECtHR, *Grubnyk v. Ukraine*, no. 58444/15, [Judgment](#), 17 September 2020, para. 115; ECtHR, *Korban v. Ukraine*, no. 26744/16, [Judgment](#), 4 July 2019, para. 155.

²⁰ IA004/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm* (“Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin”), 30 prill 2021, konfidencial, para. 19. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA004/F00005/RED.

²¹ Neni 19.1.31 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2022, Ligji nr.08/L-032 jep këtë përkufizim për termin “i artikulueshëm”: “pala e cila paraqet informacionin apo provën duhet të specifikojë në detaje informatën apo provën në të cilën mbështetet”.

²² Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin, para. 22.

(a) Rreziku i arratisjes

16. ZPS-ja parashtron se z. Thaçi vazhdon të paraqesë rrezik arratisjeje pasi ai është në dijeni të akuzave të rënda ndaj tij, dhe tani, me mbylljen e paraqitjes së provave të ZPS-së, është në dijeni të plotë të provave kundër tij që bëjnë më konkrete mundësinë e një dënimi të gjatë.²³ ZPS-ja parashtron se z. Thaçi ka tani dhe do të ketë së shpejti informacion të tjetër të ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët dhe provat që Mbrojtja e Viktimave propozon të paraqesë si pjesë e provave të saj.²⁴ ZPS-ja parashtron gjithashtu se z. Thaçi përballet tani me akuza të konfirmuara në lidhje me përpjekjet e tij të pretenduara për të penguar procesin dhe për të kryer krime të tjera.²⁵ ZPS-ja argumenton se këto rrethana shtojnë motivimin e z. Thaçi për t'u arratisur, duke krijuar mundësi të mjaftueshme reale që ai t'i ikë drejtësisë.²⁶

17. Mbrojtja parashtron se z. Thaçi nuk paraqet rrezik arratisjeje pasi: (i) as Gjykatësi i Procedurës Paraprake, as Trupi Gjykues nuk kanë vlerësuar se ai paraqet rrezik arratisjeje;²⁷ (ii) ai ka vazhduar të bashkëpunojë, është paraqitur dhe ka marrë pjesë në procesin gjyqësor gjatë dy viteve të fundit në mënyrë që nuk përputhet me dëshirën për t'i ikur drejtësisë dhe për të kaluar jetën në arrati;²⁸ (iii) Trupi Gjykues hodhi poshtë si jobindës argumentin e ZPS-së se me ecurinë e gjykimit shtohet rreziku i arratisjes, konstatoi se ZPS-ja nuk kishte vërtetuar pretendimin e vet për "mundësi të mjaftueshme reale" se, nëse lirohet, i akuzuari do të arratiset, dhe hodhi poshtë argumentin e ZPS-së se njohuria që z. Thaçi ka për konfirmimin e akuzave ndaj tij për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë shton rrezikun e arratisjes;²⁹ dhe (iv) argumenti i ZPS-së se Mbrojtja e

²³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 11.

²⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 11.

²⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 11.

²⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 11.

²⁷ Përgjigjja, para. 9.

²⁸ Përgjigjja, para. 9.

²⁹ Përgjigjja, para. 10-11.

Viktimave do të propozojë informacion tjetër të ndjeshëm në lidhje me dëshmitarë dhe prova nuk është relevant për vlerësimin e rrezikut të arratisjes.³⁰ Mbrojtja pretendon se, argumenti se “ecuria e shpejtë e gjykit” mjafton për të ndryshuar përfundimin se z. Thaçi nuk ka paraqitur kurrë rrezik arratisjeje, është i paarsyeshëm.³¹

18. Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja paraqet në thelb të njëjtat argumente që Trupi Gjykues vlerësoi dhe hodhi poshtë në vendime të mëparshme,³² në lidhje me pikat në vijim: (i) Dijenia që ka z. Thaçi për natyrën e rëndë të akuzave të konfirmuara kundër tij; (ii) mundësia e dënimit me burgim të gjatë nëse shpallet fajtor; (iii) Njohuritë e plota që z. Thaçi ka për akuzat dhe provat kundër tij; dhe (iv) Dijenia e z. Thaçi se ndaj tij janë konfirmuar akuza për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.³³ Lidhur me këtë, Trupi Gjykues rikujton konstatimin e Panelit të Gjykatës së Apelit se nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mund të pritët të shqyrtojë parashtrime të cilat thjesht përsërisin argumentet tashmë të trajtuara në vendime të mëparshme mbi rishikimin e paraburgimit.³⁴ Trupi Gjykues gjykon se ky parim vlen për Trupin Gjykues dhe për fazën aktuale të procesit gjyqësor.³⁵

19. Sa i takon argumentit të ZPS-së se z. Thaçi ka tani, ose së shpejti do të ketë, informacion tjetër të ndjeshëm në lidhje me dëshmitarë dhe prova që Mbrojtja e Viktimave propozon të paraqesë, Trupi Gjykues nuk e gjykon bindës këtë argument. ZPS-ja nuk ka provuar se si zotërimi nga z. Thaçi i informacionit të

³⁰ Përgjigjja, para. 12.

³¹ Përgjigjja, para. 13.

³² *Krahaso* Parashtrimet e ZPS-së, para. 11 *me* F03041, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 20 mars 2025, para. 9.

³³ *Shih* Vendimin e Njëzetë për Paraburgimin, para. 14-16.

³⁴ *Shih* KSC-BC-2020-04, IA003/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit (“Vendimi mbi Apelin e Shalës”)*, 11 shkurt 2022, para. 18.

³⁵ *Shih gjithashtu* Vendimi mbi Apelin e Shalës, para. 18, ku konstatohet se paneli mund t’u referohet konstatimeve të vendimeve të mëparshme nëse është bindur se provat ose informacionet mbi të cilat u bazuan këto vendime vazhdojnë të mbështesin konstatimet e bëra në kohën e rishikimit.

ndjeshëm që ka të bëjë me provat e viktimave do të ndikonte konkretisht ose të shtonte rrezikun e arratisjes. Trupi Gjykses është i mendimit se është më e përshtatshme që ky faktor të merret parasysh në vlerësimin nëse ka gjasë që z. Thaçi të pengojë procesin,³⁶ dhe rrjedhimisht, do të trajtohet më poshtë.

20. Trupi Gjykses gjykon se, ndonëse rreziku i arratisjes nuk mund të përjashtohet në tërësi, Trupi Gjykses vlerëson se ZPS-ja nuk ka vërtetuar pretendimin e “mundësisë së mjaftueshme reale” se, nëse lirohet, i akuzuari do të arratiset bazuar në fazën aktuale të procesit.³⁷ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se vazhdimi i paraburgimit të z. Thaçi aktualisht nuk përlligjet për shkak të rrezikut të arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i) dhe për rrjedhojë nuk do të trajtojë parashtrimet e mëtejshme të Mbrojtjes në lidhje me rrezikun e arratisjes.

(b) Rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së

21. Duke iu referuar konstatimeve të mëparshme të këtij Trupi Gjykses, ZPS-ja parashtron se z. Thaçi vazhdon të përbëjë rrezik për pengimin e procesit.³⁸ ZPS-ja argumenton se ekziston një atmosferë e përgjithshme e ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve të kësaj çështjeje gjyqësore dhe çështjeve të tjera gjyqësore në DHS,³⁹ që, sikurse u përcaktua nga Gjykata e Apelit, është faktor kontekstual relevant.⁴⁰ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se: (i) mbyllja e paraqitjes së provave të ZPS-së nuk e shmang këtë rrezik por e shton atë, pasi të akuzuarit kanë tani dijeni për tërësinë e akuzave kundër tyre dhe dëshmitarët mbeten të rrezikuar nga ndërhyrja edhe pas dhënies së dëshmisë së tyre; (ii) ka ende dëshmitarë që duhet të dëshmojë gjatë

³⁶ *Shih* KSC-BC-2020-05, F00355/RED, Trupi Gjykses I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Nëntë për Rishikimin e Paraburgimit*, 21 mars 2022, para. 16, 18-19.

³⁷ *Shih* Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin, para. 24.

³⁸ Parashtrimet e ZPS-së,, para. 12, 17.

³⁹ Parashtrimet e ZPS-së,, para. 16.

⁴⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 16 që i referohet IA017/F00011, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit* (“Vendimi i Tretë i Apelit mbi Paraburgimin”), 5 prill 2022, konfidencial, para. 41-48. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA017/F00011/RED.

paraqitjes së provave të Mbrojtjes së Viktimave, dhe ndoshta gjatë paraqitjes së provave të Mbrojtjes, për të cilët ekziston rreziku i ndërhyrjes; (iii) Trupi Gjykses ka konstatuar më parë se nxjerrja e informacionit tejet të ndjeshëm për Mbrojtjen e Thaçit, përfshirë të akuzuarin, rrit pashmangshmërisht mundësinë e qasjes në to, që rrjedhimisht shton rrezikun që këto informacione t'i shkojnë publikut dhe cenon mbrojtjen efektive të dëshmitarëve në rast se i akuzuari lirohet.⁴¹ Në lidhje me këtë, ZPS-ja parashtron se ky rrezik është realizuar, pasi z. Thaçi ka shkelur urdhrin e Trupit Gjykses, ndër të tjera: (i) duke u treguar vizitorëve informacion të marrë gjatë dëshmisë së dëshmitarëve të mbrojtur; dhe; (ii) duke dhënë udhëzime për dëshmitarët e ardhshëm të ZPS-së në lidhje me mënyrën dhe përmbajtjen e dëshmisë së tyre që pritej të jepej, që rezultoi në ndryshimin nga Trupi Gjykses të kushteve të paraburgimit dhe konfirmimin e akuzave kundër z. Thaçi në Çështjen 12.⁴² Sipas ZPS-së, kjo tregon se: (i) rreziku i pengimit të procesit është i bazuar mirë; (ii) sjellja e z. Thaçi dëmton sigurinë dhe mirëqenien e dëshmitarëve; dhe (iii) kjo sjellje drejtpërdrejt dëmton integritetin e procesit.⁴³

22. Mbrojtja përgjigjet se argumenti i ri i ZPS-së në lidhje me rrezikun e pengimit të procesit nuk është bindës dhe duhet të hidhet poshtë, pasi me kalimin e kohës rreziku duhet të zvogëlohet, dhe ZPS-ja nuk shpjegon pse ky rrezik nuk do të zvogëlohej apo pse dijenia e plotë e të akuzuarit për provat do të shtonte këtë rrezik.⁴⁴ Mbrojtja argumenton se mbyllja e paraqitjes së provave të ZPS-së përbën ndryshim kyç të rrethanave që zvogëlon ndjeshëm rrezikun e ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve.⁴⁵ Mbrojtja argumenton gjithashtu se mbështetja e ZPS-së në çështje të gjykuara nga gjykata të tjera në lidhje me ndërhyrjen ndaj dëshmitarëve pas

⁴¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 13-14.

⁴² Parashtrimet e ZPS-së, para. 15.

⁴³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 17.

⁴⁴ Përgjigja, para. 14-15 ku i referohet, ndër të tjera, KSC-BC-2020-07, IA007/F00004, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim Përmbledhës mbi Apelet e Nasim Haradinajt kundër Vendimeve mbi Rishikimin e Paraburgimit ("Vendimi mbi Apelin e Haradinajt në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit")*, 6 prill 2022, para. 42.

⁴⁵ Përgjigja, para. 16.

gjykimit është e papërligjur, e gabuar dhe spekulative, pasi ZPS-ja nuk ka paraqitur prova që mbështesin përfundimin se z. Thaçi do të tentojë të ndërhyjë ndaj dëshmitarëve.⁴⁶ Mbrojtja pretendon gjithashtu se argumenti i ZPS-së në lidhje me rrezikun e ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve të Mbrojtjes së Viktimave, dhe ndoshta të Mbrojtjes, shpërfill faktin se verdikti i fajësisë mund të mbështetet vetëm në provat e ZPS-së, dhe rrjedhimisht rreziku i pengimit të dëshmitarëve të Mbrojtjes së Viktimave është vetvetiu më i vogël.⁴⁷ Mbrojtja argumenton gjithashtu se nuk ka rrezik ndërhyrje ndaj dëshmitarëve për viktimat pasi Mbrojtja e Viktimave synon të thërrasë vetëm dy ekspertë ndërkombëtarë, të cilët nuk janë dëshmitarë të cenueshëm.⁴⁸ Mbrojtja parashtron se këto vlerësime vlejné për çdo dëshmitar të mundshëm të Mbrojtjes.⁴⁹ Rrjedhimisht, Mbrojtja fton Trupin Gjykses që të mos marrë parasysh asnjë argument të ri të paraqitur nga ZPS-ja.⁵⁰

23. Sikurse parashtron ZPS-ja,⁵¹ Trupi Gjykses ka konstatuar më parë dhe përsërit se z. Thaçi: (i) ka interesin dhe aftësinë për të ndërhyrë në procesin gjyqësor; (ii) është orvatur të dëmtojë DHS-në dhe u ka ofruar përfitime personave të thirrur nga ZPS-ja; (iii) ka pozitë me ndikim në Kosovë që i mundëson mbështetjen e simpatizuesve; dhe (iv) ka më shumë njohuri për provat që mbështesin akuzat e rënda kundër tij.⁵²

24. Trupi Gjykses vëren se, në lidhje me çështjen nëse mbyllja e paraqitjes së provave të ZPS-së shton apo zvogëlon rrezikun e pengimit të procesit,⁵³ Paneli i Apelit ka konstatuar se, nëse gjërat rrjedhin normalisht, me kalimin e kohës

⁴⁶ Përgjigja, para. 17.

⁴⁷ Përgjigja, para. 18.

⁴⁸ Përgjigja, para. 19.

⁴⁹ Përgjigja, para. 20.

⁵⁰ Përgjigja, para. 21.

⁵¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 12.

⁵² Vendimi i Njëzetë për Paraburgimin, para. 17; *Shih p.sh.* F00177, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Hashim Thaçit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, para. 38, 41. ("Vendimi i Parë mbi Lirimin e Përkohshëm"). Versioni i redaktuar publik u lëshua më 26 janar 2021, F00177/RED.

⁵³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 13-14; Përgjigja, para. 13.

rreziku i pengimit të procesit zvogëlohet; megjithatë, në varësi të rrethanave të çështjes, ky rrezik mund të mos zvogëlohet ndjeshëm.⁵⁴

25. Trupi Gjykses rikujton se për Mbrojtjen e Thaçit janë nxjerrë emrat dhe të dhënat personale të disa dëshmitarëve tejet të ndjeshëm të ZPS-së,⁵⁵ dhe rrjedhimisht ata janë bërë të ditur për një numër më të madh njerëzish, përfshirë z. Thaçi. Kjo, nga ana e saj, shton rrezikun që informacioni i ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët të bëhet i njohur për publikun. Ky rrezik ekziston edhe pas dhënies së dëshmisë të dëshmitarëve të ZPS-së, pasi shumë nga ta janë nën masa mbrojtëse dhe identitetet e tyre nuk duhet në asnjë mënyrë të bëhen të njohura për publikun. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se Mbrojtja e Viktimave ka dorëzuar listën e dëshmitarëve të mundshëm⁵⁶ dhe se është udhëzuar të jetë e gatshme të paraqesë provat e tij që më 16 korrik 2025.⁵⁷ Rrjedhimisht, z. Thaçi ka pasur qasje në informacion të ndjeshëm në lidhje me emrat dhe të dhënat personale të dëshmitarëve dhe deklaratave të viktimave apo informacion shtesë në lidhje me dëmin që shumë viktima pretendohet të kenë pësuar.⁵⁸ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses vlerëson se arsyetimi i ndjekur nga ai për dëshmitarët e ZPS-së vlen edhe për dëshmitarët që do të thërrasë Mbrojtja e Viktimave. Gjithashtu, rreziku i ndërhyrjes që kërkohet të shmanget përmes paraburgimit përfshin edhe, për shembull: (i) tentativat për t'u hakmarrë kundër dëshmitarëve që kanë dëshmuar

⁵⁴ Vendimi mbi Apelin e Haradinajt në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, para. 42.

⁵⁵ *Shih* Vendimin i Njëzetë për Paraburgimin, para. 18.

⁵⁶ F03209, Mbrojtja e Viktimave, *Parashtrim nga Mbrojtja e Viktimave i Listës së Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale, dhe Kërkesa lidhur me Të*, 28 maj 2025, publik, me Shtojcat 1-2, konfidencial.

⁵⁷ F03232, Trupi Gjykses, Urdhër për Caktim të Afateve dhe Datave, i Rishikuar, 5 qershor 2025, para. 7.

⁵⁸ F03206, Mbrojtja e Viktimave, *Kërkesë e Mbrojtjes së Viktimave për Pranimin e Provave sipas Rregullës 153*, 28 maj 2025, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F03206/RED. F03207, Mbrojtja e Viktimave, *Kërkesë e Mbrojtjes të Viktimave për Pranimin e Dokumenteve si Prova Jogojore*, 28 maj 2025, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F03207/RED. F03209, Mbrojtja e Viktimave, *Parashtrim nga Mbrojtja e Viktimave i Listës së Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale, dhe Kërkesë lidhur me Të*, 28 maj 2025. F03208, Mbrojtja e Viktimave, *Kërkesë e Mbrojtjes së Viktimave për Pranimin e Informacionit Shtesë në lidhje me Dëmin*, 28 maj 2025, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F03208/RED.

në këtë proces; (ii) përpjekjet për të nxitur dëshmitarët që në shkëmbim të favoreve të tërheqin dëshmitë e tyre; dhe (iii) tentativat për të ndërhyrë ndaj dëshmitarëve në procese paralele.⁵⁹ Në lidhje me pikën e fundit, Trupi Gjykses vë në dukje se vijojnë procedurat në lidhje me pretendimet për ndërhyrje në proces në çështjen aktuale.⁶⁰

26. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses rikujton konstatimet e tij të mëparshme se duket se z. Thaçi u dha vizitorëve jo të privilegjuar informacion të marrë gjatë dëshmisë së dëshmitarëve të mbrojtur.⁶¹ Gjithashtu, dokumentet sugjerojnë se ai i dha një vizitori jo të privilegjuar udhëzime në lidhje me një dëshmitar të ardhshëm të ZPS-së për mënyrën dhe përmbajtjen e dëshmisë që pritej të jepej nga ai dëshmitar.⁶² Këto konstatime mbështeten gjithashtu nga fakti se tani janë konfirmuar akuzat ndaj z. Thaçi në Çështjen 12.⁶³ Në këtë kontekst, Trupi Gjykses vlerëson se lirimi i z. Thaçi që ka në zotërim informacione të ndjeshme nuk do të ndihmonte mbrojtjen efektive të dëshmitarëve. Rrjedhimisht, për arsyet e përmendura më lart, Trupi Gjykses hedh poshtë argumentet e Mbrojtjes.

27. Gjithashtu, ky rrezik ekziston në atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve dhe të ndërhyrjes në procedurat penale kundër ish-anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”), që nuk mund të mënjanohet vetëm me masa mbrojtëse.⁶⁴

⁵⁹ F03176/COR2/RED, Trupi Gjykses, *Version i Redaktuar Publik i Versionit të Korrigjuar më Tej të Vendimit Përmbledhës në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes së Krasniqit për Lirim të Përkohshëm dhe Rishikimin e Rregullit të Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, 13 maj 2025, para. 41.

⁶⁰ KSC-BC-2023-12, F00264/A02, Prokurorja e Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar (“Aktakuza në Çështjen 12”)*, 16 prill 2025.

⁶¹ *Shih* F01977, Trupi Gjykses, *Vendim i Mëtejshëm mbi Kërkesën Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit për Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin (“Vendimi mbi Kushtet e Paraburgimit”)*, 1 dhjetor 2023, para. 35; *Vendimi i Njëzetë për Paraburgimin*, para. 19.

⁶² *Vendimi mbi Kushtet e Paraburgimit*, para. 38; *Vendimi i Njëzetë për Paraburgimin*, para. 19.

⁶³ *Aktakuza në Çështjen 12*, para. 6-8, 45.

⁶⁴ *Vendimi i Njëzetë për Paraburgimin*, para. 20. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-05, F00494/RED, Trupi Gjykses, *Aktgjykim*, 19 janar 2023, para. 57. *Versioni i korrigjuar u dorëzua më 8 qershor 2023, F00494/RED3/COR.*

28. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së.

(c) Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

29. ZPS-ja i referohet konstatimeve të Trupit Gjykses në Vendimin e Njëzetë për Paraburgimin dhe parashtron se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të kryejë krime të tjera.⁶⁵ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se rrethanat relevante që u morën parasysh në vlerësimin e rrezikut të pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së⁶⁶ janë njësoj të vlefshme për këtë pikë dhe për rrjedhojë i përfshin edhe ato.⁶⁷ ZPS-ja parashtron se fakti që ne këtë fazë z. Thaçi ka njohuri të hollësishme për çështjen gjyqësore në përgjithësi dhe provat kundër tij shton rrezikun që ai mund të kryejë krime të tjera, përfshirë kundër dëshmitarëve që kanë dhënë dëshmi ose që mund të japin dëshmi në këtë çështje dhe/ose të paraqiten para këtij trupi gjykses në faza të ardhshme të procesit gjyqësor.⁶⁸

30. Trupi Gjykses rikujton konstatimin e vet në Vendimin e Njëzetë për Paraburgimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të kryejë krime të tjera.⁶⁹ Trupi Gjykses konstaton se të njëjtët faktorë që u morën parasysh në lidhje me rrezikun e pengimit të procesit vlejné edhe për shqyrtimin e rrezikut të kryerjes së krimeve të tjera nga z. Thaçi.⁷⁰ Trupi Gjykses vë në dukje gjithashtu se, siç u shtjellua më lart,⁷¹ mbyllja e paraqitjes së provave të ZPS-së nuk e ndryshon konstatimin e Trupit Gjykses.

⁶⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 18 që i referohet Vendimit të Njëzetë për Paraburgimin, para. 23-25.

⁶⁶ *Shih më lart*, para. 20.

⁶⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 19.

⁶⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 22.

⁶⁹ Vendimi i Njëzetë për Paraburgimin, para. 25.

⁷⁰ *Shih më lart*, para. 20-26; Vendimi i Njëzetë për Paraburgimin, para. 23.

⁷¹ *Shih më lart*, para. 25-28.

31. Trupi Gjykues thekson faktin se gjykimi në këtë çështje gjyqësore është në vazhdim e sipër dhe se identitetet e dëshmitarëve të cenueshëm i janë bërë të ditur z. Thaçi, dhe se duhet të shmangët çdo rrezik i kryerjes së krimeve të tjera.

32. Trupi Gjykues gjykon se, duke marrë parasysh të gjithë faktorët së bashku, vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të kryejë krime të tjera sikurse përcaktohet në nenin 41(6)(b)(iii).

3. Përfundim

33. Trupi Gjykues arrin në përfundimin se në këtë moment nuk ka informacion të mjaftueshëm që të përlijë konstatimin se, nëse lirohet, z. Thaçi mund t'i ikë drejtësisë. Megjithatë, duke u bazuar në standardin përkatës, Trupi Gjykues është bindur se ekziston rreziku që z. Thaçi do të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së dhe do të kryejë krime të tjera kundër atyre që konsiderohen se janë kundër UÇK-së, përfshirë dëshmitarët që kanë dhënë dëshmi ose mund të japin dëshmi në këtë çështje dhe/ose që pritet të paraqiten para DHS-së. Trupi Gjykues do të vlerësojë në vijim nëse kushtet për lirim të tij i trajtojnë në mënyrë të mjaftueshme këto rreziqe.

B. MASAT ALTERNATIVE NDAJ PARABURGIMIT

34. Duke iu referuar konstatimeve të mëparshme të Trupit Gjykues, ZPS-ja parashtron se: (i) rreziqet përkatëse mund të administrohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së;⁷² (ii) asnjë nga kushtet e propozuara më parë dhe as masat shtesë të parapara në nenin 41(12) nuk mund të zvogëlojnë mjaftueshëm rreziqet ekzistuese;⁷³ (iii) komunikimet e z. Thaçi mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rreziqet e pengimit të procesit dhe të

⁷² Parashtrimet e ZPS-së, para. 23.

⁷³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 24.

kryerjes së krimeve të tjera vetëm me anë të kornizës për monitorimin e komunikimeve që zbatohet në objektin e paraburgimit të DHS-së;⁷⁴ (iv) që nga Vendimi i Njëzetë për Paraburgimin, nuk ka ndryshuar asgjë që do të përligjte një vlerësim të ndryshëm të kushteve, qoftë në përgjithësi apo për një periudhë të caktuar kohore;⁷⁵ dhe (v) sjellja e z. Thaçi tani përbën rrezik jashtëzakonisht më të madh, sa që as kufizimet standarde të komunikimit dhe monitorimi në objektin e paraburgimit nuk janë të mjaftueshme për zvogëlimin e tij.⁷⁶ ZPS-ja parashtron se, për rrjedhojë, dhe duke pasur parasysh vijimin e gjykit dhe nxjerrjen e vazhdueshme të materialeve, këto rreziqe vazhdojnë të ekzistojnë.⁷⁷

35. Gjatë marrjes së vendimit nëse një person duhet të lirohet apo të mbahet në paraburgim, Trupi Gjykes duhet të shqyrtojë masat alternative për parandalimin e rreziqeve në nenin 41(6)(b).⁷⁸ Neni 41(12) përcakton disa faktorë që duhet të merren parasysh për të siguruar praninë e të akuzuarit në gjykim, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale, apo për të siguruar kryerjen me sukses të procesit penal. Në këtë aspekt, Trupi Gjykes rikujton se paraburgimi duhet të vazhdojë vetëm nëse nuk janë të disponueshme në mënyrë të arsyeshme masa alternative më të buta, të cilat do të zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b).⁷⁹ Për këtë arsye, Trupi Gjykes duhet të shqyrtojë të gjitha masat

⁷⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 26.

⁷⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 27.

⁷⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 27.

⁷⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 27.

⁷⁸ Në lidhje me detyrimin për të shqyrtuar "masa alternative", shih KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas Nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar* ("Aktvendimi i DHSGJK-së i Datës 26 Prill 2017"), 26 prill 2017, para. 114. Shih gjithashtu ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova [GC]*, para. 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia [GC]*, no. 5826/03, [Judgment](#) ("*Idalov v. Russia [GC]*"), 22 May 2012, para. 140 *in fine*.

⁷⁹ Aktvendimi i DHSGJK-së i Datës 26 Prill 2017, para. 114; KSC-CC-PR-2020-09, F00006, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020*, 22 maj 2020, para. 70. Shih gjithashtu ECtHR, [Idalov v. Russia \[GC\]](#), para. 140.

e arsyeshme alternative që mund të vendosen dhe jo vetëm ato që parashtrojnë palët.⁸⁰

36. Në lidhje me rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së dhe të kryerjes së krimeve të tjera, Trupi Gjykses konstaton se as kushtet e propozuara më parë dhe as masat shtesë të parapara në nenin 41(12), nuk mund të zvogëlojnë mjaftueshëm rreziqet ekzistuese.⁸¹ Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton se masat në fuqi në objektin e paraburgimit të DHS-së, të para në tërësi, ofrojnë garanci të forta kundrejt vizitave dhe komunikimeve të pamonitoruara me anëtarët e familjes dhe vizitorët e miratuar paraprakisht, me synimin për të zvogëluar rrezikun e pengimit të procesit dhe të kryerjes së krimeve të tjera.⁸² Ato ofrojnë po ashtu një mjedis të kontrolluar ku një shkelje e mundshme e konfidencialitetit mund të identifikohet dhe/ose parandalohet me lehtësi.⁸³

37. Trupi Gjykses rikonfirmon më tej se vetëm me anë të kornizës për monitorimin e komunikimeve në objektin e paraburgimit të DHS-së, përfshirë masat shtesë që urdhëroi Trupi Gjykses,⁸⁴ komunikimet e z. Thaçi mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rrezikun e pengimit të procesit dhe të kryerjes së krimeve të tjera.⁸⁵

38. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se rreziku i pengimit të procesit dhe i kryerjes së krimeve të tjera mund të trajtohet në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së. Në këto rrethana, Trupi Gjykses gjykon se vazhdimi i paraburgimit të z. Thaçi është i domosdoshëm për të shmangur rreziqet në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii).

⁸⁰ IA003/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, konfidencial, para. 86. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, IA003/F00005/RED; KSC-BC-2020-05, F00127, Trupi Gjykses I, *Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit*, 25 maj 2021, para. 24.

⁸¹ Vendimi i Njëzetë për Paraburgimin, para. 29.

⁸² Vendimi i Njëzetë për Paraburgimin, para. 29.

⁸³ Vendimi i Njëzetë për Paraburgimin, para. 29.

⁸⁴ Vendimi mbi Kushtet e Paraburgimit, para. 84(c).

⁸⁵ Vendimi i Njëzetë për Paraburgimin, para. 30.

C. ARSYESHMËRIA E PARABURGIMIT

39. Duke iu referuar konstatimeve të mëparshme të Trupit Gjykses, ZPS-ja parashtron se mbajtja në paraburgim e z. Thaçi vazhdon të jetë proporcionale dhe e arsyeshme, veçanërisht duke pasur parasysh se procesi po përparon në mënyrë të arsyeshme.⁸⁶

40. Trupi Gjykses rikujton se arsyeshmëria për vazhdimin e paraburgimit të të akuzuarit duhet të vlerësohet mbi faktet e secilës çështje dhe sipas veçorive të saj.⁸⁷ Veçoritë në këtë çështje përfshijnë (i) ndikimin dhe autoritetin e z. Thaçi; (ii) njohjen me akuzat dhe provat kundër tij dhe mundësinë e dënimit me burgim të gjatë; (iii) rrezikun që z. Thaçi do të pengojë procesin e DHS-së; (iv) rrezikun e kryerjes, nxitjes ose dhënies së ndihmës për krime të tjera; (v) faktin se masat kufizuese për lirimin nuk janë të mjaftueshme për të zvogëluar rreziqet; (vi) peshën dhe kompleksitetin e akuzave kundër z. Thaçi; dhe (vii) faktin se ka filluar gjykimi, që tregon ecuri të arsyeshme të procesit.⁸⁸

41. Bazuar në rrethanat e diskutuara më lart dhe faktin se vazhdon të ekzistojë rreziku i pengimit të procesit dhe i kryerjes së krimeve të tjera – asnjë prej të cilëve nuk mund të zvogëlohet mjaftueshëm me zbatimin e masave të arsyeshme alternative – Trupi Gjykses konstaton, në rrethanat e veçanta të kësaj çështjeje, se vazhdimi i paraburgimit të z. Thaçi me dy muaj të tjerë është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.

42. Megjithatë, Trupi Gjykses thekson se z. Thaçi tashmë është mbajtur në paraburgim për një periudhë të konsiderueshme kohore dhe gjykimi i kësaj çështjeje merr kohë gjatë. Sikurse u vu në dukje më herët nga Trupi Gjykses, kjo kërkon, si nga Trupi Gjykses po ashtu dhe nga palët, të kenë veçanërisht parasysh

⁸⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 28-30 që i referohen Vendimit të Njëzetë për Paraburgimin, para. 34-35.

⁸⁷ Vendimi i Tretë i Apelit mbi Paraburgimin, para. 65.

⁸⁸ Vendimi i Njëzetë për Paraburgimin, para. 33.

që të sigurojnë kryerjen sa më të shpejtë të gjykimit. Trupi Gjykues do të vazhdojë të monitorojë në çdo fazë të këtij procesi nëse vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.

V. VENDIM

43. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- (a) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi; dhe
- (b) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Thaçi jo më vonë se të **hënën, 21 korrik 2025, në orën 16:00**, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76.

/nënshkrim/

Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E mërkurë, 11 qershor 2025

Në Hagë, Holandë.